VENDIM
Nr. 200, datë 15.8.2025

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "SOLAR HORIZON" SHPK PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE SI MJET PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT NDAJ "PROCREDIT BANK" SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 3 dhe 8 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.8.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2158/3 prot., datë 12.8.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Solar Horizon' sh.p.k për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj 'ProCredit Bank' sh.a.",

Konstatoi se:

- Shoqëria "Solar Horizon" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.4.2025.

- Me shkresën nr. 2158 prot., datë 24.7.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën/dokumentacionin për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj "ProCredit Bank" sh.a.

- Në kuadër të kësaj kërkese dhe në mbështetje të dispozitave të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, shoqëria ka depozituar, ndër të tjera: kontratat e kredisë bankare dhe kontratë pengu (kontratë pengu kuota të shoqërisë), ku citohet vendosja e pengut të radhës së parë të 100% të kuotave të kredimarrësit.

- Konstatohet se si kontratat e kredisë ashtu edhe ajo e pengut rezultojnë të nënshkruara përpara se shoqëria të ishte licencuar nga ERE, ***pra përpara se shoqërisë t'i lindte detyrimi për të marrë autorizimin e ERE-s për këtë barrësim.***

- ERE me shkresën nr. 2158/1 prot., datë 1.8.2025 i ka kërkuar shoqërisë të informojë nëse është nënshkruar ndonjë marrëveshje siguruese vijuese apo ka pasur rishikim të asaj ekzistuese me bankën pas licencimit në lidhje me barrësimin e kuotave.

- Në përgjigje me shkresën nr. 2158/2 prot., datë 6.8.2025, shoqëria bëri me dije se nga data e licencimit e deri më sot, nuk janë lidhur kontrata të tjera kredie apo garancie me "ProCredit Bank" sh.a. apo institucione të tjera bankare/financiare. Gjithashtu informon se pritet ndërmarrja e hapave të tjerë tekniko-administrativë për operimin e centralit, paketa e garancive të tjera përveç pengut mbi kuotat, të cilat nuk janë formalizuar ende, ndaj citon se do të vazhdojë të informojë ERE-n për çdo zhvillim të mëtejshëm në lidhje me marrëdhënien me këtë bankë si dhe hapat që do marrë në lidhje me ecurinë e projektit. *Ndaj ERE-s, në vijim të vendimmarrjes së Bordit, do të njoftojë shoqërinë se në çdo rast të lënies peng të aseteve të centralit, shoqëria përveç informimit duhet të përcjellë aplikimin, si dhe dokumentacionin/ informacionin përkatës, siç kërkuar në kuptim të nenit 7 të rregullores nr. 119/2016 "Rregullore e transferimit të aseteve nga të licencuarit".*

- Si e tillë, vlerësohet se ERE nuk mund të marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë për sa kohë marrëdhënia juridike me bankën për vendosje barre siguruese është krijuar përpara se shoqëria të merrte statusin e të licencuarit dhe të lindnin detyrimet përkatëse në kuadër të këtij statusi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "Solar Horizon" sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të kapitalit si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj "ProCredit Bank" sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Solar Horizon" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti